

NJOFTIM PËR SHTYP

Sot, në datë 10 tetor 2023, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës z. Denar Biba mori pjesë në konferencën e zhvilluar në Prishtinë me temë: “Dita e Konkurrencës 2023: “Përfitimet e konkurrencës së drejtë në Kosovë”, organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës me mbështetjen e Projektit të financuar nga BE: “Përkrahja e BE-së për Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore”.

Në këtë aktivitet, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Shqipërisë u përfaqësua nga Kryetari i Autoritetit Z. Denar Biba dhe Z. Durim Kraja, Anëtar i Komisionit të Konkurrencës.

Z. Biba pati kënaqësinë të diskutonte me të pranishmit duke ofruar dhe disa nga eksperiencat e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Shqipërisë gjatë Sesionit të parë me temë: Angazhimet e Kosovës të rregullojnë konkurrencën me standardet e BE –së”,

Kjo konferencë, e para e këtij lloji në Kosovë mbuloi tema të tilla si rëndësia e politikave të konkurrencës, reformat legislative, me një fokus specifik në praktikant antikonkurrese në formën e karteleve dhe manipulimit të ofertave.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe Zyrës së BE- së në Kosovë, si dhe të ftuar të tjerë nga autoritetet homologe të konkurrencës nga shtete te BE dhe rajonit.